

V E N D I M
Nr.185, datë 18.4.1995

**PËR DISA NDRYSHIME NË ÇMIMET E ENERGJISË ELEKTRIKE DHE TË UJIT TË
PIJSHËM, SI DHE NË TATIMIN E QARKULLIMIT PËR PRODHIMIN E BUKËS DHE
MIELLIT**

Me propozimin e Ministrisë së Bujqësisë dhe të Ushqimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I :

1. Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.137, datë 31.3.1994 “Për disa ndryshime në çmimet e artikujve energjetikë”, ndryshuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.206, datë 16.5.1994, në pikën 2, në paragrafin e dytë të shkronjës “b”, pas fjalëve “... dega e qymyreve” shtohen fjalët: “subjektet e prodhimit të bukës dhe miellit”.

2. Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.102, datë 16.3.1992 “Për normat e përdorimit dhe çmimin e ujit të pijshëm në qytet e në fshat”, në pikën 5 shtohet fjalia: “Çmimi i ujit të pijshëm që konsumohet nga subjektet përkatëse të prodhimit të bukës dhe të miellit, caktohet 15 lekë për 1 m³ ujë”.

3. Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.118, datë 13.3.1993 “Për moszbatimin e tatimit mbi qarkullimin”, në pikën 1, në paragrafin e parë, fjalët “buka masive, mielli i grurit për bukën masive” ndryshohen dhe bëhen “buka, mielli i grurit për bukë”.

4. Çdo akt tjetër nënligjor që bie në kundërshtim me këtë vendim, shfuqizohet.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi